



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 707 Akti

Nr. 727 Vendimi

Tiranë, më 19.12.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 18.12.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Andi Pogaçe**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (aktualisht këshilltar ligjor pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë).

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Andi Pogaçe, me detyrë prokuror në

Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 18.12.2023 kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Andi Pogaçe gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Subjekti i rivlerësimit Andi Pogaçe u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 15.12.2020 nga Komisioni, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, me trup gjykues të përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Etleda Çiftja dhe Brunilda Bekteshi.
3. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Etleda Çiftja, pasi të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit. Relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
4. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit ka nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:
 - a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
 - b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016 pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-DSIK, në vijim AKSIK), brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
 - c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.
5. Në datën 14.9.2022, komisionerja Brunilda Bekteshi paraqiti një kërkesë për dorëheqje, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke parashtruar arsyet e dorëheqjes nga rivlerësimi i subjektit (për shkak se ajo ishte anëtare e trupit gjykues që po shqyrtonte çështjen e rivlerësimit të subjektit N. T., e cila është bashkëshortja e subjektit Andi Pogaçe), duke vlerësuar se ndodhej në kushtet e “konfliktit në dukje të interesit”.

6. Me vendimin nr. ***, datë 15.9.2022, u ngrit trupi gjykues që do të merrte në shqyrtim kërkesën për dorëheqje të komisioneres Brunilda Bekteshi nga procesi për subjektin e rivlerësimit Andi Pogaçe, i cili, pasi vlerësoi pretendimet dhe argumentimet e paraqitura prej saj, bazuar në vendimin nr. ***, datë 21.1.2019, të Komisionit, me anë të të cilit është konsoliduar qëndrimi për shqyrtimin me trupa të ndryshëm të subjekteve që kanë marrëdhënie familjare midis tyre, për garantimin e paanshmërisë së gjykimit dhe vendimmarrjes, vlerësoi se kërkesa e komisioneres Brunilda Bekteshi duhej pranuar.
7. Në vijim, trupi gjykues, me vendimin nr. ***, datë 20.9.2022, vlerësoi se kërkesa për dorëheqje e komisioneres Brunilda Bekteshi gjen mbështetje ligjore në kuptim të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit “Për konfliktin e interesit” e, për këto arsye, vendosi pranimin e kërkesës së saj për dorëheqje nga procesi i rivlerësimit të çështjes së subjektit Andi Pogaçe. Në vijim, bazuar në praktikën “Për shpërndarjen me short të çështjeve të subjekteve të rivlerësimit sipas nenit 3, pika 6, shkronja “b” e rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, nga ku ka rezultuar se për trupin gjykues nr. 1 ishte shortuar si anëtar trupe zëvendësues komisioneri Roland Ilia. Ky i fundit, duke qenë se kishte qenë po ashtu anëtar i panelit të shortuar për subjektin e rivlerësimit N. T., në datën 14.9.2023 paraqiti kërkesën për dorëheqje nga shqyrtimi i çështjes së subjektit të rivlerësimit Andi Pogaçe.
8. Me vendimin nr. ***, datë 27.9.2023, u ngrit trupi gjykues që do të merrte në shqyrtim kërkesën për dorëheqje të komisionerit Roland Ilia nga procesi për subjektin e rivlerësimit Andi Pogaçe. Pasi janë vlerësuar pretendimet dhe argumentimet e paraqitura nga komisioneri Roland Ilia, është vlerësuar se kërkesa e këtij të fundit duhej pranuar. Pas procedurës së rishortimit, anëtar zëvendësues u përzgjedh komisioneri Olsi Komici.
9. Gjatë hetimit administrativ, në mënyrë të përsëritur është njoftuar subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues, duke i kërkuar gjithashtu të shprehej lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit me anëtarët e tij, sikurse janë zëvendësuar në dinamikën e lartpërmendur. Subjekti i rivlerësimit, sikurse më herët, edhe me anë të postës elektronike të datës 2.10.2023, ka konfirmuar mospasjen e ndonjë konflikti interesi me anëtarët e trupit gjykues që i ishin bërë me dije.
10. Me vendimin nr. 2, datë 4.10.2023, Komisioni vendosi të administrojë disa dokumente nga dosja e subjektit të rivlerësimit N. T., bashkëshortja e subjektit Andi Pogaçe, me qëllim vlerësimin e përfshirjes së mundshme të këtij të fundit në raport me ndonjë kontribut financiar për pasuritë e subjektit N. T., ndonëse pas analizimit të dokumentacionit të administruar nuk rezultoi një gjë e tillë.
11. Pas përfundimit të fazës hetimore mbi rivlerësimin e subjektit Andi Pogaçe, me vendimin nr. 3, datë 6.12.2023, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohet në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
12. Në datën 6.12.2023, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi atë për t’u njohur me dosjen dhe provat e administruara (nëse e vlerësonte të nevojshme), në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 e 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe për të

paraqitur shpjegimet e kërkuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë deri më 13.12.2023. Subjekti paraqiti shpjegimet e veta brenda afatit të caktuar nga Komisioni.

13. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet vendimit nr. 4, datë 13.12.2023, vendosi caktimin e seancës dëgjimore në datën 18.12.2023, duke e njoftuar subjektin përmes postës elektronike për këtë vendimmarrje.

II. SEANCA DËGJIMORE

14. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 18.12.2023, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma.
15. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, subjekti Andi Pogaçe parashtroi shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 18.12.2023 u mbyll, për të rifilluar më 19.12.2023 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

17. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës së dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLP-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; (ix) faktet e njohura botërisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

18. Bazuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

19. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.
20. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

1. Automjet tip “Peugeot 206”, blerë në vitin 2011, me vlerë 208,343 lekë

1. Në DIPP-në e vitit 2013 përpara fillimit të detyrës, subjekti ka deklaruar automjetin¹ në vlerën 2,800 euro, ndërsa në deklaratën *Vetting* e ka deklaruar atë në vlerën 208,343 lekë. Kjo pasuri është blerë rreth 2 vite përpara fillimit të detyrës nga subjekti me anë të faturës tatimore të shitjes² datë 13.11.2011, nga shoqëria “***” sh.p.k. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, ka rezultuar se pala shitëse e kishte blerë automjetin në fjalë në Itali, në datën 27.9.2011, nga shoqëria “***” s.p.a. në vlerën 1,075 euro³.
2. Si burim për krijimin e kësaj pasurie subjekti ka deklaruar se kanë shërbyer të ardhurat e prindërve të tij.
3. DPSHTRR-ja⁴ ka përcjellë dosjen e automjetit në analizë ku, ndër të tjera, gjendej edhe kontrata nr. ***, datë 5.3.2020, për shitjen e këtij automjeti në vlerën 1,500 euro.
4. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka specifikuar burimin e krijimit të pasurisë në analizë, duke sqaruar se babai i tij kishte realizuar ndër vite të ardhurat si vijon:
 - a) Të ardhurat nga punësimi i z. J. P. sipas vërtetimit të shoqërisë “***” sh.p.k.:
 - për periudhën 31.12.2004 – 31.12.2007, shumën 829,584 lekë;
 - për periudhën 1.1.2008 – 31.12.2011, shumën 7,795,673 lekë;
 - për periudhën 1.1.2012 – 31.12.2015, shumën 3,296,130 lekë;
 - për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2018, shumën 1,268,674 lekë.
 - b) Të ardhurat nga dhënia me qira e një pasurie të disponuar në qytetin e Fierit, sipas shkresës së DRT-së Fier⁵, në të cilën citohet se z. J. P. i ka dhënë me qira pronën e tij shoqërisë “***” sh.p.k., sipas kontratave në vijim, si dhe ka paguar tatimin për të ardhurat e realizuara:
 - kontrata nr. ***, datë 25.4.2000, për periudhën 1.4.2000 – 30.6.2010, qiraja 1,200 USD/muaj;

¹ Me targë ***.

² Fatura tatimore nr. serie ***, e shoqërisë “***” sh.p.k.

³ Shitësi ka paguar detyrimet doganore në vlerën 34,547 lekë.

⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2021.

⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2021.

- rishikim kontrate (nr. ***, datë 25.4.2000), datë 1.4.2005, për periudhën 1.4.2005 – 30.6.2010, qiraja 60,000 lekë/muaj;
 - kontrata nr. ***, datë 6.4.2011, për periudhën 5.4.2011 – 5.4.2015, qiraja 210,000 lekë/muaj;
 - kontrata nr. ***, datë 19.202015, për periudhën 1.1.2015 – 30.4.2015, qiraja 450,000 lekë/ muaj⁶.
5. Lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., si dhe përfaqësuesin/administratorin, z. M. D. apo ortakët e saj M., E. dhe M. D., subjekti ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 2 se nuk ka pasur asnjë marrëdhënie me ta. Ai ka paraqitur vërtetimin nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ku bëhet me dije se në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, datë 30.3.2015, ndaj subjektit M. D./D., i cili i ishte caktuar për ndjekje subjektit, në datën 3.4.2015, subjekti sapo është njohur me aktet, ka paraqitur kërkesën për heqjen dorë dhe zëvendësimin e tij nga një prokuror tjetër, për shkak të marrëdhënies së biznesit që kishin familjarët e tij me subjektin “****” sh.p.k. Kjo kërkesë është pranuar nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe ky kallëzim i është caktuar një prokurori tjetër.
 6. Sa më sipër është konfirmuar edhe nga Prokuroria, por edhe përgjatë hetimit të kryer nga Komisioni⁷.
 7. Ndërsa, lidhur me të ardhurat e realizuara prej tij, subjekti ka deklaruar se gjatë periudhës 18.11.2009 – 29.10.2010 ka qenë i punësuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë Tiranë, me pagë rreth 73,000 lekë/muaj. Subjekti ka deklaruar gjithashtu se pas largimit nga ky institucion ka përfituar në formë dëmshpërblimi të ardhurat në shumën 1,007,300 lekë, sipas vendimit nr. ***, datë 30.3.2012, të gjykatës, si dhe të ardhura të prapambetura nga ky institucion në shumën 20,000 lekë.
 8. Për sa më sipër, Komisioni ka përllogaritur mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe të prindërve të tij për të kursyer shumën 208,343 lekë deri në datën 13.11.2011 për blerjen e automjetit në analizë.
 9. Në analizën financiare për blerjen e automjetit të subjektit të kryer për periudhën 1.1.2004 – 13.11.2011 Komisioni ka marrë në analizë të ardhurat e subjektit, kredinë e marrë prej tij, e cila është likuiduar deri në datën 2.7.2008⁸, si dhe ka përllogaritur shpenzimet e jetesës sipas përbërjes familjare. Bazuar në deklarimin e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 3, si dhe provave të paraqitura prej tij, sipas të cilave rezultoi se nuk disponohej kontrata e kredisë, Komisioni ka kryer analizën financiare, duke përfshirë vetëm shumën e principalit të paguar për këtë kredi.
 10. Nga analiza e kryer rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e tij kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare në shumën 4,780,437 lekë, e cila ka qenë e mjaftueshme për blerjen e automjetit, si dhe likuidimin e kredisë,⁹ siç paraqitet në mënyrë të detajuar në tabelën në vijim.

⁶ Referuar shkresës nr. *** prot., datë 21.9.2023, përgjatë vitit 2016 shoqëria “****” sh.p.k. ka deklaruar pagesa qiraje në vlerën totale prej 3,150,000 lekësh, shumë për të cilën ka bërë edhe pagesën e tatimit përkatës.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 25.9.2023.

⁸ Sipas konfirmimit nga FiBank me shkresën nr. *** prot., datë 10.11.2023.

⁹ Në këtë analizë është konsideruar vlera e automjetit sipas çmimit të përcaktuar sipas faturës tatimore të shitjes.

Tabela nr. 1 – Analiza e burimeve për blerjen e automjetit për periudhën 2004 – 13.11.2011

Nr	Përshkrimi	2004-13.11.2011
1	TË ARDHURA	20,948,262
	Të ardhura nga qeraja babait *****	6,493,380
	Të ardhura nga paga e babait *****	8,386,010
	Të ardhura nga kredia tek ***** 2004 - 40,000€	5,069,600
	Të ardhura nga paga e vëllait	141,840
	Të ardhura nga paga e subjektit	857,432
2	SHPENZIME	9,620,492
	Shpenzime jetese për 4 persona	3,916,402
	Shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit	767,486
	Shpenzime shlyerje kredie 2004 - 2008 - 40,000€	4,936,604
3	PASURI	6,547,333
	Blerje automjeti	208,343
	Apartament babai - 2004 - 40,450 €	5,126,633
	Likuditete në bankë	1,212,357
	DIFERENCA (1-2-3)	4,780,437

2. Lidhur me depozitat bankare në Raiffeisen Bank, Intesa Sanpaolo Bank dhe BKT

11. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitat në Raiffeisen Bank, Intesa Sanpaolo Bank dhe BKT me gjendjet përkatëse. Përgjatë hetimit administrativ janë konfirmuar gjendjet dhe ka rezultuar se ato ishin krijuar me burime të ligjshme, si vijon:
12. Raiffeisen Bank¹⁰ ka bërë me dije se subjekti i rivlerësimit ka qenë klient pranë kësaj banke, por që aktualisht kjo llogari është e mbyllur.
13. Intesa Sanpaolo Bank¹¹ ka konfirmuar deklarinimin e subjektit në deklaratën *Vetting* lidhur me llogarinë e pagës dhe një llogari kursimi, të disponuara në këtë bankë, ku gjendja respektive ishte 0 (zero) lekë dhe 30,000 lekë.
14. BKT-ja¹² ka konfirmuar llogarinë e pagës nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë në emër të subjektit, si dhe një kartë krediti në limitin e aprovuar prej 200,000 lekësh.
15. Nga sa më sipër nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të llogarive të sipërpërshkruara.

3. Lidhur me apartamentin në përdorim, në Durrës

16. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë vendqëndrimi apartamentin me sipërfaqe 75 m², të ndodhur në Lagjen Nr. ***, rruga “****”, pas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, banesë me qira, sipas kontratës së qirasë nr. ***, datë 23.1.2017, të nënshkruar me shtetasin L. M. Në kontratë përcaktohej, ndër të tjera, se detyrimi për pagesën e qirasë ka qenë në shumën 15,000 lekë/muaj, duke filluar nga data 1.1.2017, me afat 1 vit me të drejtë rinovimi dhe se posedimi i këtij apartamenti nga qiramarrësi kishte filluar që në datën 1.9.2016, për efekt rregullimesh dhe punimesh.

¹⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 7.4.2021.

¹¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 9.4.2021, nga Intesa Sanpaolo Bank.

¹² Me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2021, të BKT-së.

17. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1 ka rezultuar se z. M. e kishte përfituar apartamentin në fjalë me anë të kontratës së sipërmarrjes së datës 17.11.2007, të nënshkruar me shoqërinë “****” sh.p.k., në vlerën 46,000 euro.
18. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2¹³, subjekti dhe bashkëshortja e tij, znj. T., kanë deklaruar se apartamenti është vënë në dispozicion nga qiradhënësi përpara se të lidhej kontrata, pasi apartamenti ka qenë i pabanuar dhe ka pasur nevojë për lyerje, heqje lagështire, pastrim, sistemim. Shpenzimet e kryera kanë qenë minimale dhe, për këtë arsye, nuk janë ruajtur faturat e shpenzimeve.
19. Gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, ASHK Durrës¹⁴ ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar pasuri të regjistruara në emër të subjektit, familjarëve apo bashkëshortes së tij dhe as nuk kanë qenë aplikues për pasuri në proces legalizimi.
20. FSHU-ja¹⁵ ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar kontrata të lidhura me këto institucione në emër të subjektit, familjarëve apo bashkëshortes së tij.
21. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se marrëdhënia e qirasë ka përfunduar në janar 2018, për shkak se bashkëjetuesja e tij është kthyer në shtëpinë e prindërve në Tiranë, për t’u kujdesur për nënën e sëmurë.
22. Për sa i përket pagesave mujore të qirasë, subjekti ka deklaruar se ato janë kryer *cash* në përputhje me parashikimet kontraktore. Në mbështetje të deklarimit të tij, ai ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 8.11.2023, të nënshkruar nga ish-qiradhënësi L. M., nëpërmjet së cilës konfirmohet sa më lart, si dhe parashtrohet se detyrimet tatimore janë paguar nga qiramarrësi. Ky fakt ka rezultuar i provuar edhe nga një mandatpagese nga BKT-ja, datë 12.5.2020, për pagimin e tatimit mbi të ardhurat në shumën 28,898 lekë, i paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1 për pagimin e tatimit ndaj Drejtorisë së Tatimeve për periudhën janar – dhjetor 2019.
23. Në lidhje me gjendjen aktuale juridike të pronësisë për apartamentin në fjalë, subjekti ka shpjeguar se sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ish-qiradhënësi (që gjendet bashkëlidhur deklaratës noteriale të sipërcituar), shtetasi L. M. është pajisur me certifikatën e regjistrimit të pronësisë në datën 20.1.2021 dhe, më pas, kjo pasuri i është shitur shtetases K. D. sipas kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 28.1.2022.
24. Përgjatë hetimit administrativ Komisioni është vënë në dijeni lidhur me një artikull të publikuar në median *****.al*¹⁶, i cili nuk referonte *indicie* lidhur me veprimtarinë profesionale të subjektit, por përmendte marrëdhënien e qirasë në apartamentin në analizë. Për rrjedhojë, nisur nga objekti i denoncimit, u vlerësua që ky denoncim të shqyrtohet në kuadër të kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Në këtë artikull citohej se: *“Pogaçe jeton në Durrës, në një shtëpi, që në një deklaratë herë thotë paguan qira 15,000 lekë/ e herë 18,000 lekë. Shtëpinë, sipas tij, ia ka marrë avokati, po me një pagesë të tillë nuk gjen shtëpi në Durrës, veçse në periferi, ose jeton në një shtëpi të rrënuar”*.

¹³ Administruar nga Komisioni me vendimin e ndërmjetëm nr. 2, datë 4.10.2023.

¹⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.5.2021.

¹⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.4.2021.

¹⁶ https://www.****.al****

25. Sikurse është trajtuar më sipër, vlera e qirasë ka qenë e përcaktuar në kontratë në masën 15,000 lekë dhe po kjo vlerë është deklaruar nga subjekti si në DIPP-në e vitit 2016, po ashtu edhe në deklaratën *Vetting*.
26. Ndonëse çmimi i qirasë vendoset me marrëveshje dhe vullnet të lirë mes palëve, referuar pikës 2 të VKM-së nr. 469, datë 3.6.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”, përcaktohet se: “...*vlera minimale mujore për metër katror sipërfaqe ndërtese të dhënë me qira nuk mund të jetë më e ulët se 0.3% e vlerës minimale të shitjes së pasurisë*”. Referuar udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit”, nga EKB-ja, tabela nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi, përcakton se çmimi i shitjes për metër katror në Durrës, në vitin 2016, ka qenë 67,500 lekë. Për rrjedhojë, vlera minimale në këtë rast do të ishte 202.5 lekë/m² (67,500 x 0.3% = 202.5 lekë/m²), ndërkohë që për të gjithë apartamentin vlera e qirasë sipas këtij parametri do të ishte rreth 15,187 lekë (75 x 202,5 = 15,187 lekë), pra shumë i përafërt me çmimin 15,000 lekë, të kontraktuar dhe të paguar nga subjekti.
27. Për sa më sipër, ka rezultuar se çmimi i paguar nga subjekti për qiranë, ndonëse në vlera minimale, ka qenë në përputhje me përcaktimet e akteve rregullatore të sipërpërkruara. Po ashtu, detyrimi tatimor përkatës, në raport me këtë marrëdhënie qiramarrjeje, ka rezultuar i paguar nga subjekti.
28. Gjithashtu, pasi është pyetur nga Komisioni, për sa i përket marrëdhënies së tij me shtetasin L. M., subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se me këtë shtetas nuk ka pasur asnjë marrëdhënie familjare/shoqërore dhe ka paraqitur një vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me anë të të cilit është shprehur se subjekti nuk ka hetuar ndonjë çështje me palë shtetasin në fjalë. Ky fakt është konfirmuar edhe nga Prokuroria në fjalë përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni¹⁷.
29. Nisur nga sa është përshkruar më sipër, lidhur me këtë marrëdhënie qiramarrjeje/përdorimi të subjektit me këtë pasuri, të deklaruar rregullisht, nuk janë evidentuar problematika, dyshime apo *indicie* për kryerjen e hetimeve të mëtejshme nga Komisioni.

4. Lidhur me pasuritë e deklaruara veçmas nga bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit

30. Lidhur me pasuritë e deklaruara nga personi i lidhur në deklaratën *Vetting*, Komisioni ka vlerësuar të mos i vlerësojë këto pasuri, për sa kohë dhe nisur nga fakti që vetë znj. N. T. (personi i lidhur/deklarues) ka qenë gjithashtu subjekt rivlerësimi dhe, në këtë cilësi, nga një tjetër trup gjykues i shortuar nga Komisioni, më herët është kryer edhe vlerësimi i këtyre pasurive përgjatë procesit të rivlerësimit ndaj saj, i cili është konkluduar duke e konfirmuar atë në detyrë¹⁸.

¹⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.9.2023.

¹⁸ Me vendimin nr. ***, datë 2.11.2022, vendim i cili mori formë të prerë në datën 20.12.2022, pasi nuk u ankimua.

KONSTATIME TË TJERA

5. Lidhur me një apartament me sipërfaqe 54.76 m², me vendndodhje në ***, në pronësi të prindërve të subjektit

31. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se prindërit e tij ishin pronarë sipas certifikatës së pronësisë së datës 11.12.2017, të apartamentit me sipërfaqe 60,78 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me adresë ***, Vlorë. Ai ka deklaruar se e ka përdorur këtë pasuri gjatë muajit gusht të vitit 2017, si dhe në vitet në vijim për të kaluar pushimet verore.
32. Ndonëse jemi përballë një përdorimi sporadik dhe të përkohshëm, që i përket periudhës pas deklaratës *Vetting*, meqenëse bëhet fjalë për pronësi të personave në marrëdhënie të veçantë me subjektin, Komisioni ka çmuar të kryejë një vlerësim gjithëpërfshirës, për të shuar çdo hije dyshimi në raport me burimet e krijimit të kësaj pasurie.
33. Përgjatë hetimit të kryer nga Komisioni ka rezultuar se pasuria në fjalë është porositur me anë të kontratës së datës 6.9.2014¹⁹, nënshkruar mes nënës së subjektit dhe shoqërisë “****” sh.p.k. – të përfaqësuar nga shtetasi Gj. P. Si burim për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer të ardhurat nga kursimet e prindërve të subjektit në shumën 15,000 euro, si dhe kredia e marrë prej tyre në Tirana Bank, në datën 31.10.2014²⁰, në shumën 4,000,000 lekë. Si garanci për marrjen e kredisë prindërit e subjektit kishin vendosur apartamentin në pronësi të tyre me sipërfaqe 71,66 m², të ndodhur në Fier, duke lidhur një kontratë hipoteke²¹ me Tirana Bank.
34. Kredia është disbursuar në datën 14.11.2014, në llogarinë e babait të subjektit. Po në këtë datë, 14.11.2014, është transferuar në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k. shuma 3,891,000 lekë.
35. Shitja e apartamentit në analizë është finalizuar me anë të kontratës së shitblerjes²² së datës 17.11.2017 mes prindërve të subjektit dhe shoqërisë “****” sh.p.k. dhe është regjistruar në emër të tyre në datën 11.12.2017, sipas certifikatës së pronësisë me nr. ***.
36. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se me shtetasin Gj. P., si dhe shoqërinë “****” sh.p.k. nuk ka pasur asnjë marrëdhënie familjare/shoqërore. Ai ka paraqitur vërtetimin nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me anë të të cilit është konfirmuar se subjekti nuk ka hetuar çështje me palë shtetasin në fjalë dhe as me shoqërinë “****” sh.p.k. Sa më sipër është konfirmuar edhe nga Prokuroria përgjatë hetimit të kryer nga Komisioni²³.

5.1 Analiza e burimit të krijimit të pasurisë²⁴

¹⁹ Kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.9.2014, në shkresën kthim përgjigjeje të MD-së, nr. ***, datë 23.3.2021.

²⁰ Kontratë kredie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.10.2014, në shkresën kthim përgjigjeje të Tirana Bank me nr. *** prot., datë 19.9.2023. Në këtë kontratë citohet se për blerjen e këtij apartamenti kredimarrësit kanë parapaguar vlerën 15,000 euro.

²¹ Kontratë hipoteke nr. *** kol., datë 31.10.2014, në shkresën kthim përgjigjeje të Tirana Bank me nr. *** prot., datë 14.9.2020.

²² Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 17.11.2017, në shkresën kthim përgjigjeje të MD-së, nr. ***, datë 23.3.2021.

²³ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.9.2023.

²⁴ Ndonëse kjo pasuri nuk përfshihet në pasuritë që janë objekt i detyrueshëm vlerësimi në këtë proces, në rastin konkret – nisur nga përdorimi sporadik i subjektit – Komisioni çmoi të vlerësonte edhe burimet e krijimit të kësaj pasurie, me qëllim shterimin e çdo dyshimi të mundshëm.

37. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka sqaruar se në datën 6.9.2014 është lidhur kontrata e shitblerjes së sendit të ardhshëm nr. ***, në vlerën 45,000 euro. Si burim për likuidimin e çmimit të apartamentit në vlerën 45,000 euro kanë shërbyer të ardhurat dhe kursimet e prindërve të tij ndër vite, si dhe pjesërisht të ardhurat e tij në formë kontributi ndaj familjes. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti ka rezultuar se vlera e apartamentit është likuiduar me dy këste, konkretisht, shuma e parapaguar prej 15,000 euro dhe kredia e marrë në vlerën 4,000,000 lekë, të cilat analizohen në mënyrë të detajuar në vijim.

5.1.1 Lidhur me pagesën e kështit të parë prej 15,000 euro

38. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar se shuma e parapaguar prej 15,000 euro ishte parashikuar të likuidohet në këtë mënyrë: 5,000 euro në datën 24.7.2014 dhe 10,000 euro në datën 3.9.2014, likuidime të realizuara²⁵ pranë bankës Crédit Agricole.

39. Lidhur me burimin e ligjshëm të kryerjes së këtyre pagesave, sipas veprimeve të pasqyruara në ekstraktin e llogarisë bankare ka rezultuar se nga nëna e tij, znj. N. P., ka kryer 3 depozitime në llogari: depozitimi në datën 13.9.2006 në shumën 186,100 lekë, depozitimi në datën 17.9.2007 në shumën 124,000 lekë, si dhe depozitimi në datën 18. 9.2008 në shumën 61,600 lekë, ku përshkrimi i veprimit është shënuar “Të ardhura nga kursimet”. Këto depozita, së bashku me interesat e akumuluar, kanë krijuar shumën 1,230,000 lekë, e cila është tërhequr në datën 22.7.2014 nga Raiffeisen Bank dhe, pasi është konvertuar në euro, është përdorur për shlyerjen e kështit 10,000 euro, sipas mandatpagesës datë 3.9.2014. Pagesa është depozituar në llogarinë e shoqërisë nga babai i subjektit, z. J. P. Pagesa e kështit tjetër prej 5,000 euro është realizuar nga kursimet e prindërve, si nga të ardhurat e punës, ashtu edhe nga të ardhurat nga qiraja (nga viti 2011 deri në vitin 2015 vetëm shuma e qirasë ka qenë 210,000 lekë/muaj).

40. Po kështu, subjekti në datën 30.7.2014 ka tërhequr nga llogaria e tij në Tirana Bank shumën 1,007,300 lekë, të disponuar prej tij nga dëmshpërblimi për largim të padrejtë nga puna dhe ua ka dhënë prindërve në formë ndihme për shkak të investimit që ata po kryenin.

41. Nga përlllogaritja e burimeve të ligjshme të përdorura për krijimin e kësaj pasurie, subjekti dhe prindërit e tij kanë rezultuar me burime të ligjshme financiare, të mjaftueshme për krijimin e pasurisë në analizë, siç paraqitet në mënyrë të detajuar në tabelat në vijim, në të cilat evidentohet analiza e kryer në datat kur janë likuiduar kështet përkatëse.

²⁵ Përpara se subjekti të emërohej në detyrën e prokurorit.

Tabela nr. 2 – Analiza financiare për pagesën e shumës 5,000 euro në datën 24.7.2014

Nr	Përshkrimi	2004 - 24.7.2014
1	TË ARDHURA	30,193,898
	Të ardhura nga qiraja babait *****	11,816,880
	Të ardhura nga paga e babait *****	10,876,321
	Teë ardhura nga paga e babait *****	474,715
	Të ardhura nga kredia tek ***** 2004 - 40,000€	5,069,600
	Të ardhura nga paga e vëllait	141,840
	Të ardhura nga paga e subjektit 31.7.2013	1,814,542
2	SHPENZIME	14,206,900
	Shpenzime jetese 2004-31.7.2013 për 4 persona	4,809,401
	Shpenzime jetese 1.8.2013-24.7.2014 për 3 persona	299,458
	Shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit 2004-31.7.2013	2,071,785
	Shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit	1,801,941
	Shpenzime shkollimi vëllai i subjektit 2013	287,711
	Shpenzime për shlyerje kredie 2004 - 2.7.2008 - 40,000€	4,936,604
3	PASURI	6,436,925
	Blerje apartament babai - 2004 - 40,450 €	5,126,633
	Blerje automjeti subjekti 2011	208,343
	Blerje automjeti vëllai 2011	401,070
	Blerje apartamenti babai i subjektit 2014	700,550
	Likuiditete në bankë	329
	DIFERENCA (1-2-3)	9,550,073

Tabela nr. 3 – Analiza financiare për pagesën e shumës 10,000 euro në datën 3.9.2014

Nr	Përshkrimi	24.7.2014 - 3.9.2014
1	TË ARDHURA	10,838,473
	Të ardhura nga qiraja babait *****	180,000
	Të ardhura nga paga e babait *****	62,373
	Të ardhura nga paga e babait *****	46,027
	Të ardhura nga periudha e më përparme	9,550,073
	Të ardhura nga dhurimi i subjektit 2014	1,000,000
2	SHPENZIME	827,821
	Shpenzime jetese për 3 persona	54,246
	Shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit	773,575
3	PASURI	1,401,614
	Blerje apartamenti babai i subjektit 2014	1,401,100
	Likuiditete në bankë	514
	DIFERENCA (1-2-3)	8,609,038

42. Në përfundim, nga analiza e kryer nga Komisioni ka rezultuar se totali i pagesave të kryera për likuidimin e apartamentit në analizë ka qenë në shumën 43,549 euro, referuar kontratës së shitblerjes së sipërcituar çmimi i apartamentit ka qenë në vlerën 45,000 euro. Për rrjedhojë, ka rezultuar se prindërit e subjektit nuk kanë likuiduar plotësisht çmimin e apartamentit sipas kontratës, pasi sipas përlllogaritjeve ka rezultuar se ato kanë ende të palikuiduar shumën 1,451 euro (e konvertuar në vlerën 203,300 lekë sipas kursit të këmbimit të vitit 2014).
43. Gjithsesi, kjo diferencë nuk ka peshë në vlerësimin e kësaj pasurie (që nuk është e subjektit), për sa kohë mjaftueshmëria financiare e prindërve të tij ka qenë e bollshme për të mbuluar edhe përtej çmimit total, pasi, sikurse evidentohet në tabelën e mësipërme, në datën 3.9.2009, kur është kryer pagesa e fundit ndaj shoqërisë, prindërit e subjektit rezultonin me një bilanc pozitiv në shumën 8,609,038 lekë.

5.1.1.1 Lidhur me kredinë e marrë në Tirana Bank

44. Sipas kontratës për shitblerje të sendit të ardhshëm me nr. ***, shuma e mbetur prej 30,000 euro e çmimit të shitjes do të shlyhej nëpërmjet një kredie bankare deri në datën 30.9.2014. Për këtë qëllim, në datën 31.10.2014 është lidhur kontrata e kredisë bankare nr. *** me Tirana Bank, për shumën 4,000,000 lekë, me afat shlyerjeje 96 muaj. Si garanci për këtë kredi është vendosur apartamenti me sip. 66 m², ndodhur në Fier, në pronësi të tyre. Kredia në fjalë është disbursuar në datën 14.11.2014.
45. Në kontratën e kredisë bankare citohet shprehimisht se kjo kredi është marrë me qëllim blerjen e apartamentit në Vlorë dhe se kredimarrësi ka investuar shumën 15,000 euro, që përbën paradhënien e kontratës me nr. ***, datë 6.9.2014. Për garantimin e kësaj kredie është lidhur edhe kontrata e hipotekimit të pasurisë nr. ***, z. k. ***, e ndodhur në lagjen “****”, në qytetin e Fierit. Në përputhje me parashikimin e kontratës kredia është shlyer përfundimisht në datën 14.11.2022 (pas një periudhe 8- vjeçare). Subjekti ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 3 se për shlyerjen e kredisë kanë shërbyer të ardhurat nga punësimi dhe nga qiratë. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës kontratat e sipërpërmendura dhe mandatpagesat e dy kësteve të para, vërtetimin e lëshuar në datën 8.11.2023, nga Tirana Bank lidhur me shlyerjen e kredisë, historikun e pagesave të të gjitha kësteve të kredisë deri në mbylljen e saj, në datën 14.11.2022.
46. Në vijim të sa është përshkruar e analizuar më sipër, ka rezultuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e krijimit të pasurisë apartament, i ndodhur në ***, Vlorë, për sa kohë blerja është kryer nga prindërit e subjektit (përpara emërimit në detyrë të subjektit), si dhe është financuar nga kursime me burime të ligjshme edhe nga kredia e marrë prej tyre.

6. Apartament me sipërfaqe 106.4 m², ndodhur në rrugën “**”, Tiranë, në pronësi të prindërve të subjektit**

47. Nisur nga fakti që në përgjigje të pyetësorit nr. 1 subjekti ka deklaruar se ka pasur në përdorim pasurinë e llojit apartament të ndodhur në rrugën “****”, në Tiranë, pasuri në pronësi të prindërve të tij dhe që më pas i është dhuruar subjektit, Komisioni ka kryer një vlerësim edhe lidhur me burimet e ligjshme të përdorura për krijimin e kësaj pasurie.
48. Në mbështetje të deklaramit të tij, subjekti ka paraqitur certifikatën e pronësie nr. ***, lëshuar në datën 6.3.2020, me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, të ndodhur në rrugën “****”, në Tiranë, në emër të z. J. P. Në vijim, me anë të kontratës së dhurimit²⁶ datë 19.8.2020, kjo pasuri i është dhuruar subjektit të rivlerësimit²⁷.
49. Gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni ka rezultuar se në datën 26.9.2007 babai i subjektit, z. J. P., ka nënshkruar një kontratë shitblerjeje²⁸ me shoqërinë “****” sh.p.k. për blerjen e apartamentit nr. ***, z. k. ***, me sip. 106.4 m² dhe sipërfaqe të përbashkëta 7.2 m², e ndodhur në pallatin “****” sh.p.k., në rrugën “****”, Tiranë, kundrejt çmimit 40,450 euro, çmim i cili është paguar jashtë zyrës noteriale.
50. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka shpjeguar se si burim për krijimin e kësaj pasurie ka shërbyer kredia e marrë në vitin 2004 pranë Fibank në Tiranë, e cila ka qenë e vetmja

²⁶ Kontratë dhurimi nr. ***, datë 19.8.2020.

²⁷ Konfirmuar edhe nga RNSH-ja.

²⁸ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.9.2007 – përpara emërimit të subjektit në detyrën e prokurorit.

degë e kësaj banke në Shqipëri, duke filluar nga viti 1999. Kjo bankë u përthith nga shoqëria bijë "First Investment Bank Albania" sh.a. në korrik të vitit 2007. Për shkak se kanë kaluar më shumë se 18 vjet, nuk është bërë e mundur gjetja e kopjes së kontratës së kredisë. Si garanci për marrjen e kësaj kredie është vendosur apartamenti në pronësi të prindërve të subjektit, i ndodhur në Fier.

51. Subjekti ka vënë në dispozicion një shkresë "informacion" të datës 7.11.2023 nga noterja M. P., ku konfirmohet se në datën 4.10.2004 shtetasi J. P. ka lidhur kontratën e kredisë nr. ***, për shumën 40,000 euro me Bankën e Investimeve me qëllim blerje apartamenti. Kjo kontratë është regjistruar në librin e veprimeve noteriale në faqen *** të regjistrit, por fizikisht kontrata është asgjësuar sipas procesverbalit për asgjësimin e akteve noteriale²⁹.
52. Referuar deklaratës noteriale nr. ***, datë 27.11.2007, ka rezultuar se është bërë lirimi i hipotekës së vendosur për marrjen e kredisë në fjalë. Si burim të ligjshëm për shlyerjen e kredisë subjekti ka sqaruar se kanë shërbyer të ardhurat nga punësimi, si dhe të ardhurat nga qiraja e objektit godinë + truall të ndodhur në rrugën "****", Fier.
53. Komisioni, duke pasur parasysh se: (i) pasuria në analizë është përfituar nga prindërit e subjektit të rivlerësimit rreth 10 vjet përpara fillimit të detyrës së prokurorit prej tij; (ii) si burim krijimi për këtë pasuri ka shërbyer kredia e marrë prej tyre; (iii) duke mbajtur në vëmendje të ardhurat e prindërve të subjektit dhe të këtij të fundit në periudhën përkatëse, vlerësohet e panevojshme kryerja e një analize financiare të mirëfilltë lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, për sa kohë nuk konstatohen dyshime apo problematika që mund të lidhen apo të impaktojnë subjektin e rivlerësimit.

7. Apartament banimi në përdorim në lagjen "**", Fier**

54. Nisur nga fakti se subjekti ka deklaruar si një ndër vendbanimet e tij edhe apartamentin në pronësi të nënës së tij, të ndodhur në Fier, nëpërmjet pyetësorit nr. 2 Komisioni e ka ftuar subjektin që të paraqiste dokumentacionin ligjor, që provon mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie nga prindërit, si dhe dokumentacionin që provon statusin juridik aktual të saj.
55. Në përgjigje të këtij pyetësori, subjekti ka deklaruar se në datën 24.11.1993 ndërmjet babait të tij J. P. dhe Ndërmarrjes Komunale të Banesave është lidhur kontrata e privatizimit të banesës sipas ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore". Pas kryerjes së procedurave në përputhje me ligjin "Për privatizimin e banesave shtetërore" banesa është regjistruar në emër të shtetasve M. P. (gjyshja e subjektit), J. P. (babai) dhe N. P. (nëna), të cilët kanë qenë personat madhorë sipas përbërjes familjare në vitin 1992 me këto të dhëna: pasuria nr. ***, volumi ***, faqe ***, z. k. ***, me adresë lagjja "****", Fier. Sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore të datës 18.8.2014, rezulton se në datën 26.12.1998 gjyshja e subjektit M. P. ka ndërruar jetë dhe si trashëgimtar i vetëm i saj është caktuar i biri, J. P. Për këtë arsye, bashkëpronarë në apartament pas vdekjes së gjyshes kanë qenë prindërit J. dhe N. P., fakt ky i pasqyruar edhe në certifikatën për vërtetim pronësie të datës 2.9.2014.

²⁹ Subjekti ka paraqitur një kopje të deklaratës noteriale për "Lirim hipoteke", nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.11.2007, në përmbajtje të së cilës citohet se: "Me kontratën e kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.10.2004, të redaktuar nga notere M. P., kredimarrësit J. P. i është akorduar nga kredidhënësi, Banka e Parë e Investimeve, një kredi në shumën 40,000 euro. Për sigurimin e kësaj kredie është vendosur një barrë hipotekore mbi pasurinë nr. ***, volumi ***, faqe ***, z. k. ***, Fier, dhe me anë të kësaj deklaratë noteriale është bërë lirimi i plotë i pronës dhe fshirja e të gjitha inskriptimeve në favor të bankës".

56. Lidhur me statusin juridik aktual të pasurisë, subjekti ka sqaruar se në datën 27.7.2022 është lidhur kontrata e dhurimit nr. ***, sipas së cilës babai J. P. ia ka dhuruar pjesën e tij takuese në masën 2/3 bashkëshortes së tij, N. P., e cila rezulton në cilësinë e pranueses së dhurimit në këtë kontratë. Gjithashtu, ka rezultuar se për këtë dhurim është marrë edhe pëlqimi i Tirana Bank, në favor të së cilës ishte hipotekuar pasuria (deklarata noteriale nr. ***, datë 25.7.2022).
57. Bazuar në këtë kontratë dhurimi, sipas certifikatës së regjistrimit të pronësisë së datës 24.8.2022, rezulton se aktualisht ky apartament është vetëm në emër të nënës së subjektit, znj. N. P. Në mbështetje të deklaramëve të mësipërme, subjekti ka paraqitur dokumentacionin që dispononte në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë dhe statusin juridik aktual të saj.
58. Nisur nga sa më sipër, ka rezultuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me pasurinë apartament të ndodhur në lagjen “****”, në Fier, për sa kohë ajo rezultoi të jetë përfituar nëpërmjet procedurave të privatizimit në vitin 1993.

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

59. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaramet periodike ndër vite të subjektit, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre është vlerësuar mjaftueshmëria e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
60. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat për pasuritë e realizuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, të pasqyruara në vitin e kryerjes së investimit me vlerën e përcaktuar në dokumentacionin përkatës (të përfitimit), të gjitha të ardhurat e deklaruara ndër vite dhe të ardhurat e dokumentuara, bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, bashkëngjitur deklaratës *Vetting* dhe, në përgjigje të pyetësorëve, gjendja e likuiditeteve, shpenzimet jetike, si dhe shpenzimet e arsimimit e të udhëtimeve sipas rishikimeve të kryera, në funksion të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, kur ato kanë rezultuar të bazuara mbi dokumentacion provues dhe janë vlerësuar bindëse nga rrethanat dhe faktet e provuara edhe në mënyrë të tërthortë.
61. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke nisur nga viti 2013, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga ana e subjektit pranë ILDKPKI-së, nga ku ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm pozitiv, siç është detajuar në tabelën më poshtë.

Viti	Deri ne 2013	2014	2015	2016
PASURI	198,131	-209	425,039	-91,204
Automjet *****	208,343			
Ndryshim likuiditeti	-10,212	-209	425,039	-91,204
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	209	425,039	333,835	35,410
PASURI NETO	198,131	-209	425,039	-91,204
Të ARDHURA dokumentuar	636,788	2,223,711	1,381,155	2,491,504
Të ardhura nga paga e subjektit	636,788	2,223,711	1,381,155	1,459,549
SHPENZIME	141,024	1,227,298	264,237	283,092
Shpenzime jetese	141,024	219,998	224,276	235,092
Shpenzime për impjant gazi për makinën				48,000
Shpenzime për dhurim prinderve për blerje apartamenti 2014		1,007,300		
Shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit		0	39,961	
Analiza dokumentuar	297,633	996,622	691,879	2,299,616
Kursi i këmbimit EUR				
Kursi i këmbimit USD				
DIFERENCA E PA MBULUAR	0			

62. Në përfundim, nga hetimi administrativ i kryer dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
63. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Andi Pogaçe ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

64. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë pranë Komisionit një raport me nr. *** prot., datë 2.11.2017 – pa përgjigjen e njërit prej organeve ligjzbatuese – me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit Andi Pogaçe.
65. Me shkresën e datës 19.1.2017 është bërë më dije se edhe pas mbërritjes së përgjigjes së munguar nuk ishin konstatuar elemente të reja, që mund të ndryshonin konstatimin e mësipërm.
66. Gjithashtu, në vijim, nëpërmjet shkresave të datave 21.6.2022, 28.7.2023, 7.8.2023 dhe 16.8.2023 organet ligjzbatuese i kanë bërë me dije Komisionit se nga verifikimet e kryera nuk janë disponuar të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme të subjektit të rivlerësimit.
67. Në vijim të kërkesës së Komisionit për një përditësim e deklasifikim të raportit të tyre, AKSIK-ja, me shkresën e datës 4.9.2023, ka përcjellë pranë Komisionit raportin e sipërcituar të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 30.8.2023, të KDZH-së.
68. Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar që subjekti të ketë qenë i përfshirë në veprimtari të kundërligjshme apo të ketë pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kësisoj, në përfundim të hetimit për kriterin e kontrollit të figurës, bazuar në informacionet dhe dokumentet e administruara, ka rezultuar

se subjekti i rivlerësimit Andi Pogaçe arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga verifikimet e kryera: (i) nuk rezultoi se ajo ka pasur apo të ketë aktualisht kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) ka dorëzuar në kohë deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk ka bërë deklarime të pasakta, të paplota dhe nuk ka fshehur të dhëna apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kësisoj, subjekti arrin një nivel të besueshëm në kriterin e kontrollit të figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

69. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Andi Pogaçe, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës.
70. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer dhe të përcjellë në Komision; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet dhe organet ligjzbatuese, burime të cilat, kur ka qenë nevoja, i janë nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
71. Raporti i përcjellë nga KLP-ja është kontrolluar në drejtim të saktësisë dhe të standardizimit të tij, raport i cili ka të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit, si: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional.
72. Në raport bëhet me dije se Prokuroria e Përgjithshme ka konfirmuar se nuk ka çështje penale të filluara apo kallëzim ndaj subjektit të rivlerësimit Andi Pogaçe, por për periudhën 2006 – 2020 janë regjistruar 5 ankesa, të cilat, pasi janë shqyrtuar, një pjesë e tyre janë arkivuar, për shkak se nuk kanë rezultuar problematika lidhur me veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit.
73. Gjithashtu, në raport parashtrohet se ndaj subjektit të rivlerësimit Andi Pogaçe ka rezultuar se ndaj prokurorit Andi Pogaçe është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda kallëzimi penal nr. ***, viti 2018, për të cilin pas verifikimit është vendosur mosfillimi i procedimit penal.
74. Po ashtu, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit A. M., i cili ka pretenduar se prokurori Andi Pogaçe ka vepruar në kundërshtim me ligjin, kur ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2016. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka vendosur mosfillimin e këtij materiali hetimor, datë 4.1.2019, me argumentet se vendimi i prokurorit është ndërmarrë në përputhje me përcaktimet ligjore, pas administrimit të një sërë aktesh e provash, mbi bazën e të cilave është vendosur pushimi i procedimit penal.
75. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***25.10.2019 mbi bazën e kallëzimit të shtetasit A. H., e cila ka pretenduar se prokurori Andi Pogaçe dhe oficeri i policisë gjyqësore, D. I., kanë kryer veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga nenet 248 dhe 250 të Kodit

Penal, pasi prokurori ka paraqitur një kallëzim ndaj saj përpara oficerit të policisë gjyqësore (kjo shtetase ka paraqitur edhe një prej ankesave të rezultuara ndaj subjektit). Prokuroria e Rrethit Vlorë, me vendimin datë 7.11.2019, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke argumentuar se prokurori Andi Pogaçe ka paraqitur kallëzim penal në cilësinë e kallëzuesit. Në funksion të detyrës së tij si prokuror nuk ka kryer asnjë veprim në lidhje me rastin e kallëzuar dhe nuk ka shkelur asnjë dispozitë ligjore.

C/1. Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni

76. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet publike, të administruara për këtë qëllim. Për sa i përket tri dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti, por edhe atyre të administruara mbi bazë shorti, Komisioni, përgjithësisht, nuk ka konstatuar problematika.

DENONCIME NGA PUBLIKU

77. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit deri në këtë fazë të hetimit janë paraqitur nga publiku gjithsej 10 denoncime, disa prej të cilave kanë qenë të përsëritura. Të gjitha denoncimet janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të denoncimeve, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore, për të vlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur nga publiku pranë këtij institucioni, ka konstatuar sa vijon:

1. Denoncimet nr. * prot., datë 28.12.2021, nr. *** prot., datë 29.12.2017, nr. *** prot., datë 3.12.2018, të shtetasve A. M. dhe M. P.**

78. Denoncuesit kanë ngritur pretendime lidhur me një vendim të marrë nga gjykata për kallëzimin e bërë prej tyre ndaj disa gjyqtarëve dhe prokurorëve, mes tyre edhe ndaj subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, bashkëlidhur ka rezultuar edhe një ankesë drejtuar ish-KLD-së me të njëjtën përmbajtje me denoncimin nr. *** prot., e cila është trajtuar edhe në raportin e KLP-së.

79. Gjatë hetimit, Komisioni ka konstatuar se kallëzimi i denoncuesit është marrë në shqyrtim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, e cila në datën 4.1.2019 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

80. Për sa më sipër, sikurse kishte konkluduar edhe KLP-ja lidhur me ankesën ndaj subjektit, sa i takojnë denoncimeve në fjalë nuk janë evidentuar problematika në kuadër të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

2. Denoncimi nr. * prot., datë 29.12.2017, i shtetasit A. Rr.**

81. Denoncuesi ka ngritur pretendime ndaj disa gjyqtarëve dhe prokurorëve, por nuk ka rezultuar të ketë ndonjë pretendim apo ankesë specifike për subjektin e rivlerësimit dhe as nuk ka paraqitur ndonjë dokument lidhur me veprimtarinë profesionale të subjektit në raport me denoncimin e tij.

82. Për sa më sipër, nuk kanë rezultuar të plotësuara elementet e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe as ndonjë *indicie* për thellimin e hetimit në kuadër të kriterit profesional për subjektin e rivlerësimit Andi Pogaçe.

3. Denoncimet nr. * prot., datë 12.4.2008 dhe nr. *** , datë 23.1.2019, të shtetases L. Z.**

83. Denoncuesja ka përmendur disa gjyqtarë dhe prokurorë, ndërmjet tyre edhe subjektin e rivlerësimit. Ajo ka pretenduar se ata kanë shkelur ligjin, si dhe kanë shpërdoruar detyrën, duke dënuar djalin e saj padrejtësisht me 25 vite burg.

84. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se hetimet lidhur me çështjen objekt denoncimi janë kryer nga një tjetër prokuror dhe jo nga subjekti i rivlerësimit Andi Pogaçe (ndonëse ky denoncim është marrë edhe më parë në shqyrtim nga Komisioni dhe nuk është konkluduar për shkelje procedurale për sa pretendohet).

85. Në këto kushte, ky denoncim nuk mund të merret në konsideratë nga Komisioni në kuadër të vlerësimit profesional të subjektit, për sa kohë nuk referon *indicie* apo prova lidhur me veprimtarinë e tij gjatë ushtrimit të detyrës si prokuror, pasi nuk i përmbush elementet e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

4. Denoncimi nr. * prot., datë 15.5.2018, i shtetasit L. M.**

86. Denoncuesi ka përmendur disa gjyqtarë dhe prokurorë, ndërmjet tyre edhe subjektin e rivlerësimit. Sikurse është vlerësuar edhe më herët nga Komisioni për të tjera subjekte, përmbajtja e këtij denoncimi nuk referon *indicie* në kuadër të aftësive profesionale të subjekteve të përmendura në të dhe, kështu, nuk i përmbush elementet e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

87. Gjithsesi, përgjatë hetimit të kryer nga Komisioni, ka rezultuar se kallëzimi objekt denoncimi është depozituar dhe marrë në shqyrtim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, e cila në datën 4.1.2019 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Në përfundim të analizimit të dokumentacionit të administruar nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi në veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

5. Denoncimi nr. * prot., datë 24.5.2018, i shtetasit M. I.**

88. Denoncuesi ka pretenduar se vendimi i datës 23.2.2017 për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, viti 2016, që ka pasur për objekt verifikimin e kallëzimit të denoncuesit në ngarkim të prokurorit E. M. dhe oficerit të policisë gjyqësore M. F., ka qenë i padrejtë. Denoncuesi është shprehur se prokurori ka mbajtur të njëjtin qëndrim që kishin mbajtur edhe prokuroritë dhe gjykatat, të cilat kishin ndjekur më parë çështjen objekt denoncimi.

89. Nga shqyrtimi i vendimit të dhënë nga prokurori Andi Pogaçe, ka rezultuar se pas kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale, shqyrtimit të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, në përfundim, subjekti ka arsyetuar se nuk konstatoheshin elemente të anës objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”. Prokurori është shprehur në vendim se pretendimet e tjera të denoncuesit ishin objekt ankimi ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Vendimmarrja e subjektit i është komunikuar rregullisht denoncuesit. Gjithashtu, denoncuesi është orientuar nga subjekti për zgjidhjen procedurale të pretendimeve të tij.

90. Për sa më sipër, ka rezultuar se subjekti ka ndërmarrë hapat e duhur hetimorë. Arsyetimi ka qenë i plotë dhe i mjaftueshëm, ndonëse Komisioni nuk mund të analizojë dhe të shprehet mbi vlerësimin e provave. Në këtë rast nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mosrespektim i të drejtave të palëve nga subjekti.

6. Denoncimet nr. * prot., datë 22.10.2021 dhe nr. *** prot., datë 9.3.2022, të shtetasit B.M., përfaqësuar nga av. A. B. dhe studioja ligjore “****”**

91. Në këtë denoncimin pretendohet se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar caktimin e masës së sigurisë “arrest në burg”, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 230 të Kodit të Procedurës Penale, pasi i dyshuari ishte i sëmurë dhe mbi moshën 70 vjeç, duke mos arsyetuar kërkesën, si dhe duke mos marrë në konsideratë kërkesat e përfaqësuesve për lëshimin e autorizimit për vizitë te kardiologu.

92. Pasi është pyetur nga Komisioni lidhur me këtë çështje, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka sqaruar se nga policia gjyqësore ishte referuar materiali kallëzues nr. ***³⁰. Në datën 24.9.2021 është nxjerrë urdhri “Për regjistrimin e veprës penale” lidhur me regjistrimin e veprës penale “Shkatërrim i pronës me zjarr”, sipas nenit 151/2 të Kodit Penal, si dhe urdhri “Për regjistrimin e emrit të personit nën hetim” në ngarkim të shtetasit B. M. Po në të njëjtën datë është marrë në pyetje i dyshuari dhe në datën 25.9.2021 është paraqitur në gjykatë kërkesa për vleftësimin e arrestimit dhe caktimin e masës së sigurimit, bazuar në nenin 238 të Kodit të Procedurës Penale “Arrest në burg”, me afat 45 ditë³¹.

93. Kërkesa është argumentuar bazuar në faktin se shtetasi B. M. ka qenë i dënuar më parë; është munduar t'i shmanget përgjegjësisë; përhapja e veprës penale; rreziku i largimit; rëndësia e faktit penal në kuptim të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se vepra penale për të cilën dyshohej shtetasi B. M. (neni 151/2 i Kodit Penal) parashikonte një dënim deri në 10 vjet burgim; referuar shkresës së Qendrës Shëndetësore nr. ***, datë 24.9.2021, i dyshuari nuk kishte nevojë për ndonjë trajtim mjekësor specifik që nuk ofrohej nga institucioni. Me vendimin nr. ***, datë 26.9.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit.

94. Në vijim, pas evidentimit të dëmit sipas aktit të ekspertimit vlerësues, e cila kishte rezultuar në shumën 27,596,600 lekë³², është kërkuar zëvendësimi i masës së sigurimit “Arrest në burg me afat”, duke caktuar si masë sigurimi “Arrest në burg”. Në datën 5.11.2021 është marrë vendimi “Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës”, për kryerjen e veprës penale “Shkatërrimi i pronës me zjarr”, me pasoja të rënda, parashikuar në nenin 151/2 të Kodit Penal. Kërkesa për ndryshimin e masës është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. ***, datë 5.11.2021³³. Vendimi i është komunikuar të pandehurit dhe mbrojtësit të tij në datën 10.11.2021.

95. Me vendimin nr. ***, datë 28.2.2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur deklarinimin fajtor të shtetasit B. M. për kryerjen e veprës penale të parashikuar në nenin 151/2 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim.

³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 24.9.2021, e Komisarariatit të Policisë Fier.

³¹ Për shkak se ende nuk ishte kryer ekspertimi për përcaktimin e vlerës konkrete të dëmit.

³² Ekspertimi ekonomik është kryer në datën 25.10.2021 nga Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Lushnjë dhe shkresa përcjellëse e tij mban datën 26.10.2021.

³³ Në vijim, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 18.10.2021, ka vendosur “Miratimin e vendimit nr. ***, datë 26.9.2021, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”. Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, por me vendimin nr. ***, datë 21.6.2022, Gjykata e Lartë ka vendosur “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi B.M.”.

96. Nga sa më sipër, sikurse është konfirmuar edhe nga gjykatat më të larta, veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit, si për sa i përket kohëzgjatjes së hetimit³⁴, por edhe mënyrës së përfundimit të tij, kanë qenë të plota dhe të gjithanshme.
97. Për sa i përket pretendimit të denoncuesit lidhur me moshën e të pandehurit, referuar nenit 230 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe arsyetimit të gjykatave lidhur me këtë çështje, krahas garancive që lidhen me moshën, gjendjen shëndetësore apo detyrimet ndaj fëmijëve të mitur, parashikohen edhe rrethanat përjashtimore nga zbatimi i këtyre garancive, siç është në rastin konkret rrethana cilësuese, e parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit 151 të Kodit Penal, e cila parashikon maksimumin e masës së dënimit të autorit, me 10 vjet burgim.
98. Për rrjedhojë, kryerja e veprës penale me pasoja shumë të rënda, qëndrimi mohues i të dyshuarit, si dhe qenia edhe më parë e tij i dënuar, janë konsideruar si nga prokurori, por edhe nga gjykatat në të tria shkallët, si shkaqe të një rëndësie të veçantë, që e bëjnë të domosdoshme vendosjen e kësaj mase sigurimi dhe në përputhje me pikën 3 të nenit 230, ku përcaktohet se: *“3. Në rastet e parashikuara në pikën 2, arresti në burg mund të vendoset vetëm kur ka shkaqe të një rëndësie të veçantë për krimet që dënohen jo më pak në maksimum se dhjetë vjet burgim”*.
99. Për sa më sipër, nuk janë evidentuar shkelje procedurale ose të drejta të palëve apo mangësi në veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

Lidhur me disa artikuj të publikuar në median online

1. Komisioni është vënë në dijeni dhe ka analizuar një artikull të publikuar në median *.al³⁵**

100. Në këtë artikull, ndër të tjera, citohet se: *“Pogaçe jeton në Durrës, në një shtëpi, që në një deklaratë herë thotë paguan qira 15,000 lekë në muaj e herë 18,000 lekë. Shtëpinë sipas tij ia ka marrë avokati, po me një pagesë të tillë nuk gjen shtëpi në Durrës, veçse në periferi, ose në ndonjë shtëpi të rrënuar”*.
101. Komisioni, nisur nga përmbajtja e tij, e ka trajtuar këtë artikull në kriterin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke kryer vlerësimet përkatëse mbi dokumentacionin e disponuar dhe mbi shpjegimet e dhëna nga subjekti.

2. Lidhur me një denoncim të bërë në programin “**”, në TV ***³⁶**

102. Emisioni investigativ “****” ka bërë publik një debat mes të afërmish, i cili ka degraduar në dhunë fizike, ku shtetasi G. N. është goditur me grushte, ndërsa djali i tij V. N. me një mjet hekuri. Sipas të dëmtuarve, prokurori Andi Pogaçe ka kërkuar dënimin e tyre, duke mos marrë në konsideratë raportin mjekoligjor të dëmtimeve të shtetasit V. N. dhe as dëshmitë e të pranishmëve në konflikt.
103. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka shpjeguar se në datën 19.10.2019 është regjistruar procedimi penal nr. *** mbi bazën e referimit nga Komisariati i Policisë Fier. Në po këtë datë është kryer edhe regjistrimi i emrave të personave nën hetim, G. N., V. N.

³⁴ Hetimet kanë përfunduar brenda afatit të përcaktuar në nenin 327/2 të Kodit të Procedurës Penale, pasi emri i personit që i atribuohet vepra penale është regjistruar në datën 24.9.2021, ndërsa hetimet kanë përfunduar që në datën 10.11.2021.

³⁵ https://www.***.al/****

³⁶ https://***.tv***.al/****

dhe S. N. Në vijim janë kryer veprimet hetimore³⁷, ndër të tjera janë administruar aktet e ekspertimit mjekoligjor, me qëllim përcaktimin e dëmtimeve dhe kategorisë së tyre. Me aktin e ekspertimit mjekoligjor nr. ***, datë 7.8.2019, ishte arritur në përfundimin se shtetasi V. N. kishte pësuar dëmtime me mjet të fortë mprehës, që kishin sjellë humbjen e aftësisë së tij për punë në masën mbi 9 ditë. Në datën 25.9.2021 u është realizuar komunikimi i akuzave shtetasve G. N. dhe V. N., pyetja e tyre në cilësinë e të pandehurve, si dhe njoftimi i përfundimit të hetimeve³⁸.

104. Në datën 14.10.2021, për personin nën hetim S. N., i dyshuar për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a/3 i Kodit Penal, subjekti ka kërkuar pushimin e akuzës, me arsyetimin se veprimet e tij kanë qenë në zmbropsje të sulmit të padrejtë, që të afërmit e tij V. N. dhe G. N. kishin ndërmarrë ndaj tij.
105. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 15.11.2021, ka vendosur pushimin e akuzave ndaj të pandehurve G. N. dhe V. N., me arsyetimin se marrëdhënia e tyre me shtetasin e dëmtuar S. N. nuk mbrohet nga neni 130/a i Kodit Penal, duke qenë se nuk futen në kategorinë e gjinisë së afërt. Vepra penale e konsumuar prej tij, e parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, sipas nenit 59 të Kodit Penal ndiqet me kërkesë të viktimës akuzuese drejtpërdrejt në gjykatë. Në këto kushte, ndryshe nga sa ka kërkuar prokurori/subjekti i rivlerësimit, ndjekja penale nëpërmjet organit procedues nuk mund të vazhdonte.
106. Lidhur me këtë vlerësim të gjykatës, subjekti ka parashtruar se praktika gjyqësore nuk ka qenë e unifikuar dhe i është referuar për analogji qëndrimit të mbajtur në një rast të ngjashëm nga Gjykata e Lartë³⁹, në të cilin konkludohet se djemtë e xhaxhallarëve konsiderohen në kategorinë e gjinisë së afërt.
107. Pas ankimit nga subjekti, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 22.2.2022, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 15.11.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me këtë ndryshim: pranimin e kërkesës pjesërisht. Dërgimin për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit G. N., të akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 130/a/4 e 25 të Kodit Penal ndaj viktimës S.N., së bashku me kërkesën e të pandehurit G. N. për të proceduar me gjykimin e shkurtuar”.
108. Sipas shkresës nr. *** prot., datë 9.11.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, aktualisht procedimi penal në ngarkim të të pandehurit G. N. është në gjykim.

³⁷ Si: pyetja e personave nën hetim, si dhe pyetja e shtetasve R. N., U. N., A. N., V. J.; administrimi i akteve të gjendjes civile, me qëllim përcaktimin e lidhjes familjare; marrja e informacionit lidhur me faktin nëse shtetasit K. N., S. N. dhe A. N. kishin apo jo armë gjuhu të regjistruar dhe administrimin e praktikës përkatëse; është marrë informacioni nga gjykata nëse ndaj personave nën hetim kishte apo jo gjykime civile/penale; është kërkuar raporti i vlerësimit nga shërbimi i provës Fier etj. Në zbatim të nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale janë marrë vendimet përkatëse për zgjatjen e afatit të hetimit të datave 15.1.2020, 16.4.2020, 14.7.2020, 15.10.2020, 16.1.2021, 17.4.2021 dhe 14.7.2021. Lidhur me nevojën për zgjatjen e afatit të hetimeve, subjekti ka shpjeguar se përveç faktit se nevojitej kryerja e disa veprimeve hetimore, ka ndikuar edhe ngarkesa e lartë që ai ka pasur në atë periudhë.

³⁸ Subjekti ka sqaruar se është bërë një gabim material lidhur me datën e njoftimit të përfundimit të hetimeve, pasi data është shënuar 25.10.2021 në vend të datës 25.9.2021.

³⁹ Në vendimin nr. ***, datë 31.5.2022, ka theksuar se: “29. Në rastin konkret, kallëzuesi dhe i gjykuari N. O. kanë qenë gjini e afërt me njëri-tjetrin, pasi kallëzuesi dhe i gjykuari janë fëmijë vëllezërisht. Ushtrimi i dhunës fizike apo psikike midis personave që janë në këtë lidhje gjini me njëri-tjetrin është e dënueshme penalisht sipas nenit 130/a/1 të Kodit Penal. Në këto kushte, i gjykuari ka qenë subjekt i kësaj vepre penale, prandaj vendimet e gjykatave më të ulëta që kanë pushuar çështjen penale në ngarkim të tij, nuk janë të bazuara në ligj”.

109. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar për çështjen në fjalë, Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka arsyetuar në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse proporcionalitetin mes sulmit nga shtetasi V. N. dhe veprimeve të shtetasit S. N. për zbrapsjen e këtij sulmi, si dhe pasojat që kanë sjellë këto veprime.
110. Komisioni e ftoi subjektin të paraqiste shpjegime shteruese mbi sa më sipër, si dhe mbi cilësimin juridik të veprës penale që u atribuohet shtetasve V. N. dhe S. N.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

111. Subjekti ka parashtruar se nga hetimi i kryer është konkluduar se: (i) kanë qenë shtetasit G. N. dhe V. N. ata të cilët kanë shkuar në banesën e shtetasit S. N., duke u futur në oborrin e banesës dhe duke mos pranuar të largohen, pavarësisht se u është kërkuar nga S. N.; (ii) shtetasi S. N. ka qenë në banesë me familjen e tij, përfshirë këtu edhe fëmijët e mitur; (iii) shtetasi V. N. ka qenë i pari që ka goditur shtetasin S. N., edhe pse shtetasi S. N. nuk ka kryer asnjë veprim ndaj tij, por përkundrazi, ka kthyer kokën, për shkak se djali i tij i mitur i moshës 4 vjeç e ka kapur nga këmba dhe ka filluar të qajë i frikësuar nga situata e krijuar; (iv) si pasojë e goditjes së shtetasit V. N., shtetasi S. N. është rrëzuar duke zënë përfund edhe djalin e tij, i cili e mbante nga këmba; (v) i gjendur përballë një sulmi të papritur dhe të atëçastshëm, si dhe duke pasur parasysh edhe praninë e fëmijës së mitur dhe detyrimin për ta mbrojtur atë, shtetasi S. N. ka reaguar duke e përplasur shtetasin V. N. në murin e shtëpisë dhe, më pas, janë konfliktuar me grushte; (vi) duke vlerësuar rrethanat në të cilat ndodhej shtetasi Saimir Nushi, rezulton se veprimet e tij për të zbrapsur sulmin kanë qenë proporcionale me sulmin dhe nuk ka përdorur mjete të forta, sikurse kanë pretenduar shtetasit G. N. dhe V. N. Këto rrethana janë në përputhje me nenin 19 të Kodit Penal, i cili parashikon se *“Nuk ka përgjegjësi penale personi që ka kryer veprën, duke qenë i detyruar të mbrojtë jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tij ose të një tjetri nga një sulm i padrejtë, i vërtetë dhe i çastit, me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit”*. Sulmi i ushtruar nga shtetasi V. N. ka qenë i padrejtë, i vërtetë dhe i çastit. Reagimi i shtetasit S. N. ka qenë proporcional me sulmin edhe në kushtet kur shtetasit G. N. dhe V. N. nuk kanë pranuar të dalin nga banesa. Në vlerësimin e kësaj rrethane duhet të mbahet parasysh edhe deklarimi i shtetasit A. N., i cili ka shpjeguar se në momentin që ka shkuar në banesë, ka parë shtetasin V. N., që ofendonte shtetasin S. N. dhe familjen e tij dhe kërkonte të konfliktohej sërish me shtetasin S. N.
112. Lidhur me konstatimin e dytë për sa i përket cilësimit juridik të faktit penal në ngarkim të shtetasve V. N. dhe S. N., subjekti ka shpjeguar se nga ana e tij janë marrë në konsideratë aspekte si: natyra e veçantë e veprës penale “Dhuna në familje”, duke qenë se mbrojtja ndaj dhunës në familje është në nivel ndërkombëtar; ndryshimet e nenit 130/a të Kodit Penal, e ndryshuar me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013, ligjin nr. 35/2020, datë 16.4.2020, si dhe qëndrimin e mbajtur në vendimin nr. 38, datë 25.3.2016, nga Gjykata Kushtetuese, e cila është shprehur se: *“Në legjislacionin tonë nuk gjendet një përkufizim i farefisnisë ose lidhjes gjinore, por nga tërësia e dispozitave të sipërcituara rezulton se farefisnia natyrore bazohet në lidhjen e gjakut që ekziston ndërmjet personave që janë në gjini midis tyre. ...Shkalla përfaqëson distancën ndërmjet dy apo më shumë personave që kanë bazë lidhje gjinore. Numri i shkallës tregon afërsinë ndërmjet dy apo më shumë personave që janë në gjini”* (vendimi nr. ***, datë 28.3.2013, i Gjykatës së Lartë). Bazuar në këto rrethana, në referim të nenit 360 të Kodit Civil, rezulton se trashëgimia ligjore zbatohet deri tek të

afërmit në shkallë të gjashtë, çka presupozon se deri në këtë shkallë ekziston një marrëdhënie familjare e mbrojtur me ligj. Shtetasit V. N. dhe S. N. janë në lidhje gjinie në shkallë të pestë midis tyre, duke qenë në këtë mënyrë brenda shkallës së afërsisë që parashikon Kodi Civil dhe duke u konsideruar një marrëdhënie familjare e mbrojtur nga ligji; në rastin konkret, është marrë në konsideratë edhe fakti që i pranishëm në konflikt ka qenë edhe fëmija i mitur i viktimës së veprës penale S. N., fakt ky i pranuar edhe nga gjykatat. Ndaj dhe të dy të pandehurit janë akuzuar për kryerjen e veprës penale “Dhuna në familje”, të kryer në bashkëpunim dhe në prani të fëmijës, të parashikuar në nenet 130/a/4 dhe 25 të Kodit Penal. Në këtë aspekt vlen të theksohet se Gjykata e Apelit Vlorë nuk e ka ndryshuar cilësimin juridik për të pandehurin G. N., duke arsyetuar se si rrethana cilësuese (prania e fëmijës), ashtu edhe rrethana rënduese (kryerja e veprës penale në bashkëpunim) janë të pranishme dhe janë evidentuar saktë nga prokuroria.

Vlerësimi i trupit gjykues

113. Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe shqyrtoi dokumentacionin e administruar për çështjen në analizë, vlerëson se subjekti ka përmbushur detyrimin e tij si prokuror, i cili është hetimi i plotë dhe i gjithanshëm, në mënyrë që përpara gjykatës të parashtrohej më pas një tablo e qartë e ngjarjes së ndodhur.
114. Për sa i përket përmbushjes së detyrimit për arsyetim të hollësishëm të elementeve të nenit 19 të Kodit Penal nga ana e subjektit, pavarësisht se rrethanat e parashtruara lidhur me çështjen kanë qenë të qarta, trupi gjykues çmon se shkalla e arsyetimit mund të variojë sipas llojit të vendimeve dhe rrethanave konkrete të çështjes.
115. Lidhur me konstatimin se Gjykata e Shkallës së Parë i ka dhënë faktit një përcaktim tjetër, pasi ka bërë një interpretim të ndryshëm të shkallës së afërsisë gjinore, i cili është vlerësuar i pabazuar më pas nga gjykata më e lartë, trupi gjykues çmon se ky fakt dëshmon paqartësinë dhe qëndrimet e ndryshme që mbahen në praktikë për sa i përket interpretimit të nenit 130/a të Kodit Penal.
116. Në vlerësim të kësaj situatë faktike, pa e shtrirë vlerësimin në themelin e çështjes, trupi gjykues çmon se rrethanat e analizuar më sipër nuk janë të mjaftueshme për t’u vlerësuar sipas kërkesave të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, për pasojë trupi gjykues nuk mund të konkludojë se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e aplikimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

3. Lidhur me një artikull, në këtë rast të publikuar nga portali “**”⁴⁰**

117. Komisioni është vënë në dijeni dhe ka analizuar përmbajtjen dhe pretendimet e përshkuara në këtë artikull ku, ndër të tjera, shkruhej se: *“Prokurori Andi Pogaçe urdhëroi arrestimin e bashkëpunëtorit të policisë H. B., me të cilin policia realizoi një operacion të suksesshëm për zbulimin e minave me telekomandë në Fier. Thuhet se prokurori Andi Pogaçe është paguar nga grupi “****” i minave me telekomandë, për ta prangosur bashkëpunëtorin e policisë si hakmarrje. KLP-ja duhet ta përcjellë në ILD e në SPAK këtë skandal të prokurorit të Fierit, Andi Pogaçe, mbasi veprimi i tij ka brenda 4 vepra penale, 2 ndër të cilat janë: vendimmarrja jashtë Kodit të Procedurës Penale dhe lidhja me grupin kriminal. Për më tepër që në 6 vitet e fundit për prokurorin e Fierit, Andi Pogaçe, Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit kanë kërkuar 4 herë hetim, për 22 raste lirimi kriminelësh*

⁴⁰ https://***.net/***

e trafikantësh, deformim, shpërfillje e fshehje provash policore në favor të tyre. Madje, në 8 raste kërcënimesh për vrasje, grabitje, dhunë, plagosje me leva e me armë, të denoncuar edhe në media, Pogaçe nuk ka arrestuar autorët e krimeve, por të dëmtuarit prej tyre, për shkak se ai bën pazare me kriminelët në Fier, mes tyre edhe me R. Ç., i cili e urdhëron”.

118. Lidhur me sa është përshkruar më sipër, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka parashtruar se Prokuroria ka regjistruar procedimin penal nr. *** në ngarkim të shtetasit E. J., i dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar në nenin 282/a të Kodit Penal, i cili ishte arrestuar në datën 17.6.2021. Çështja i ka kaluar subjektit me shortin e datës 8.10.2021, duke qenë se prokurori i mëparshëm ishte komanduar në një detyrë tjetër. Pas njohjes me aktet, ai ka marrë vendimet për zgjatjen e afatit të hetimeve, si dhe ka paraqitur kërkesë për zgjatjen e afateve të paraburgimit, e cila është pranuar me vendimin nr. ***, datë 14.6.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
119. Duke qenë se kishte dyshime se shtetasi H. B. kishte komunikuar me shtetasin E. J. dhe i kishte dhënë pakot e sekuestruara më pas nga policia, është kërkuar paraqitja e tij për të dhënë deklarime, por ai nuk është paraqitur. Për këtë arsye është urdhëruar shoqërimi i detyrueshëm, i cili gjithashtu nuk është realizuar, pasi sipas informacionit të Komisarariatit të Policisë *** ky shtetas nuk gjendej në banesë⁴¹. Në datën 22.9.2022 është nxjerrë urdhri i ndalimit, është kryer ndalimi i shtetasit H. B., është ushtruar kontroll në banesën e tij, si dhe është pyetur në prani të avokatit mbrojtës. Shtetasi H. B. është shprehur se nuk kishte lidhje me ngjarjen dhe se shtetasin E. J. nuk e njihte. Ai ka pretenduar se për ngjarjen e datës 17.6.2021 kishte bashkëpunuar me punonjësit e policisë E. A. (ish-shef i Komisarariatit të Policisë *** dhe G. P. (ish-shef i Komisarariatit të Policisë ***). Në procesverbalin e datës 23.9.2022, ai ka deklaruar se kishte dijeni për ngjarjen ku është arrestuar shtetasi E. J.⁴². I pyetur nëse ka pasur ndonjë autorizim apo marrëveshje bashkëpunimi me Prokurorinë apo Policinë për këtë ngjarje, ai ka deklaruar se nuk ka pasur ndonjë marrëveshje, edhe pse mendonte se kishte.
120. Shtetasi A. M. (punonjësi i policisë që ka kryer ndalimin për kontroll të automjetit që drejtohej nga shtetasi E. J.) ka deklaruar se nuk ka pasur asnjë informacion në rrugë operative për këtë mjet. Po kështu, me shkresën e datës 24.5.2023 është kërkuar informacion lidhur me faktin nëse ka pasur apo jo informacion paraprak lidhur me ngjarjen e datës 17.6.2021 dhe në datën 1.6.2023 Drejtoria Vendore e Policisë Fier ka kthyer përgjigje se nuk kanë pasur të dhëna⁴³.
121. Me vendimin e datës 2.9.2022 është vendosur: 1. Ndarja e akteve të çështjes penale nr. ***, të vitit 2021, për veprën penale “Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse dhe helmuese”, e kryer në bashkëpunim me qëllim tregtimi, të parashikuar nga neni 282/a/2 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit E. J. Ky shtetas është dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier me 10 vjet burgim. 2. Regjistrimi i akteve që lidhen me veprën penale “Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse dhe helmuese”, e kryer në bashkëpunim

⁴¹ Subjekti ka paraqitur procesverbalet e njoftimit dhe kthim-përgjigjet përkatëse të komisarariatit të policisë.

⁴² Ndër të tjera, ai ka deklaruar se i ka thënë shtetasit E. A. se shtetasi E. J. kishte armë për të shitur në Kukës dhe ai i është përgjigjur se: “T’ia bëjmë shefit të Komisarariatit të *** se e kam shok”. Ai më pas ka komunikuar me shtetasin G. P. në rrjetin social ***. Ai deklaroi se i ka kërkuar G. nëse do i fuste ndonjë agjent të Fierit, por ky i fundit i është përgjigjur: “Jo, na e mbaro ti këtë punë”. Ai deklaroi se është njohur me shtetasin E. J. 2 muaj para se të ndodhte ngjarja tek mbikalimi i ***, pasi e ka marrë me makinë për në Durrës. I pyetur se ku ndodhej aparati telefonik me të cilin kishte komunikuar me shtetasin E. A. dhe G. P., shtetasi H. B. deklaroi se do e paraqiste atë (por nuk e ka paraqitur në asnjë moment këtë aparat).

⁴³ Subjekti ka paraqitur procesverbalin e pyetjes së shtetasit A. M., shkresën e datës 24.5.2023, si dhe shkresën kthim përgjigjeje të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier.

me qëllim tregtimi, parashikuar nga neni 282/a/2 i Kodit Penal në fashikullin e ri të procedimit penal⁴⁴.

122. Subjekti ka shpjeguar se ky procedim në ngarkim të H. B. aktualisht është në hetim pranë një prokurori tjetër, pas komandimit të subjektit si këshilltar ligjor pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
123. Me vendimin nr. ***, datë 25.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është vendosur vleftësimi i ligjshëm i ndalimit të shtetasit H. B. dhe caktimi i masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar në nenin 238 të Kodit të Procedurës Penale.
124. Në vijim, pas ankimit nga shtetasi H. B., Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin e datës 18.10.2022, ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë, duke ndryshuar llojin e masës. Ajo ka caktuar masat e sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, të shtetasit H. B., si person i dyshuar për veprën penale të parashikuar nga neni 282/a/2 i Kodit Penal⁴⁵.
125. Në përfundim, Komisioni vlerëson se në rastin në analizë është konstatuar se në raport me veprimtarinë e subjektit në këtë dosje – ndonëse ajo ka qenë e pjesshme dhe vetëm në një segment kohor/qendror (pasi hetimi është nisur nga një tjetër prokuror dhe pas aktivizimit/përfshirjes së pjesshme të subjektit, hetimi është vijuar gjithashtu nga një tjetër prokuror) – nuk kanë rezultuar shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, duhet të mbahet në vëmendje se ndonëse veprimet e subjektit janë përshkruar dhe analizuar më sipër, për sa kohë kjo dosje është ende nën hetim, çmohet se në lidhje me të as nuk mund të kryhet nga Komisioni një vlerësim i plotë dhe përfundimtar në raport me aftësitë profesionale të subjektit.
126. Në konkluzion përfundimtar lidhur me kriterin e aftësive profesionale, Komisioni çmon se për subjektin e rivlerësimit nuk është konstatuar mangësi profesionale, mosrespektim i të drejtave të palëve apo të dispozitave që përcaktojnë hapat proceduralë e, kësisoj, z. Andi Pogaçe vlerësohet me një nivel profesional bindshëm kualifikues.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Andi Pogaçe:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma,

⁴⁴ Vendimi për ndarjen e çështjes është paraqitur nga subjekti në cilësinë e provës.

⁴⁵ Subjekti ka paraqitur vendimin nr. ***, datë 25.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ankimin ndaj vendimit të shtetasit H. B., si dhe shkurtimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë.

në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Andi Pogaçe, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 19.12.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Lulzim HAMITAJ
Relator

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Jonida Vrana